



GJETJE NGA RAPORTI I VLERËSIMIT

MBI PRAKTIKAT E MEKANIZMIT TË BUXHETIMIT ME
PJESËMARRJE DHE KONSULTIMIT NË NIVEL VENDOR

NË BASHKINË KAMËZ

SHTATOR 2019



GJETJE NGA RAPORTI I VLERËSIMIT
MBI PRAKTIKAT E MEKANIZMIT TË BUXHETIMIT ME
PJESËMARRJE DHE KONSULTIMIT NË NIVEL VENDOR
NË BASHKINË KAMËZ

SHTATOR 2019



GJETJET NGA BASHKIA KAMËZ

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Me ndarjen e re territoriale Bashkia Kamëz përfshiu në juridiksionin e saj dhe ish-komunën Paskuqan. Sot ajo përbëhet nga 3 njësi administrative (Kamëz, Paskuqan dhe Bathore). Kryeqendra e bashkisë është Kamza dhe në përbërjen e saj ka 14 fshatra. Sipërfaqja është 37.18 km². Sipas Censurit të vitit 2011 Bashkia Kamëz ka një popullsi prej 104.190 banorësh, ndërsa sipas regjistrimit civil numëron 125.632 banorë. Sipas vlerësimeve të stafit të Bashkisë së Kamzës, në territorin e kësaj bashkie ndodhen edhe 50.000 banorë të paregjistruar. Kamza është bashkia me sipërfaqen më të vogël dhe me densitetin më të lartë në Shqipëri.

STAFI I BASHKISË

- Sipas 80% të të intervistuarve, Bashkia Kamëz ka mekanizma të pjesëmarrjes dhe konsultimit me qytetarët dhe BP është është një prej tyre. Të tjerë mekanizma që veçohen nga të intervistuarit janë takimet konsultative, takime me grupet e interesit për tematika të ndryshme dhe dëgjuesat publike.
- Sipas të intervistuarve BP ka nisur të zbatohet në Bashkinë Kamëz që nga viti 2009 dhe 90% e punonjësve të bashkisë të intervistuar të Bashkisë mendonin që procesi kishte mbi 3 vjet që zhvillohej. Në lidhje me pyetjen se kush e ka nisur për herë të parë si proces, të intervistuarit përgjigjen se është inicuar nga Këshilli Bashkisë, Kryetari dhe stafi, pra është një proces i inicuar dhe vazhduar nga vetë Bashkia Kamëz. Të intervistuarit nuk kishin informacion nëse procesi i buxhetimit gjinor bëhej në Bashkinë Kamëz, por nga burimet zyrtare konfirmohet që nuk është kryer ndonjëherë.
- Të pyetur nëse ka vendime apo rregullore apo vendime të miratuara nga KB apo Kryetari i Bashkisë 80% e të intervistuarve u përgjigjën pozitivisht dhe pjesa tjetër dhanë përgjigje negative, duke specifikuar se nuk mund ta gjenin këtë dokumentacion. Por nga ana tjetër 10% e të intervistuarve mendojnë që rregullorja e Këshillit Bashkiak është dokumenti i cili rregullon dhe procesin e BP.
- Stafi i Bashkisë Kamëz në përgjithësi ka dijeni për organizimin e procesit BP dhe hapat e ndërmarra në të, por vërehet që në referimin specifik ka konfuzion për etapat dhe përfundimin e procesit. Asnjë i intervistuar nuk flet për institucionalizimin e procesit nga KB. Nga përgjigjet lihet të kuptohet që mungon një praktikë e mirëpërcaktuar që do të lehtësonte procesin nga nisja deri në përfundimin të tij.
- Po kështu i njëjti konfuzion vërehet edhe në përgjigjet e marra për strukturën përgjegjëse për organizimin e BP-së, të cilat variojnë nga titullari i institucionit, Drejtoria e Financës, Arsimit, Kulturës, etj., pra pothuaj të gjitha drejtoritë e bashkisë. Stafi i Bashkisë Kamëz e mendon gjithëpërfshirës këtë proces dhe të gjithë të intervistuarit deklarojnë që të gjithë përfshihen në BP.

- Po kështu, të gjithë të intervistuarit kur pyeten për mjetet e njoftimit dhe përfshirjen qytetare në këtë proces raportojnë se lajmërimet përmes mediave sociale, mediave lokale dhe lajmërimet individuale ishin mënyrat më të përdorura nga bashkia. Ndërkohë që 20% e tyre raportonin që regjistri elektronik dhe posta elektrtonike përdorej ndonjëherë.
- Të intervistuarit përmendin se duhen përdorur të gjitha mjetet për sigurimin e të grupeve të synuara që nga media sociale, TV lokale dhe njoftimin individual, por në asnjë rast nuk përmendet ndërlidhësi komunitar. Ndërkohë që të intervistuarit mendojnë që ka nevojë për përmirësim të këtij procesi duke theksuar nevojën për shpeshësinë e takimeve dhe trajnime për fuqizimin e ndërgjegjësimin e komunitetit dhe rolin e mediave në të.
- Të gjithë të intervistuarit kishin dijeni për ekzistencën e një regjistri elektronik për dëgjuesat publike, madje kishin informacion që përditësohej rregullisht, por 70% e të intervistuarve mendonin që struktura përgjegjëse për përditësimin e tij ishte Drejtoria e Buxhetit dhe Ekonomisë, ndërsa 30% e të intervistuarve nuk kishin dijeni dhe u përgjigjen “drejtoria përkatëse” pa e specifikuar atë.
- Duket se monitorimi dhe vlerësimi i proceseve vijon të mbetet sfida për bashkitë në vend. Në Bashkinë Kamëz 40% e të intervistuarve përgjigjen që ka një sistem monitorimi, ndërsa 60% e tyre që ky sistem mungon. Por më tepër vërehet konfuzion kur kërkohen detaje në lidhje me këtë proces monitorimi (indiktorët apo struktura përgjegjëse) dhe të intervistuarit nuk kanë dhënë përgjigje për këtë pyetje.
- Punonjësit e Bashkisë Kamëz vlerësojnë se puna me qytetarin vazhdon të mbetet një sfida. Gjithashtu, ndër vështirësitë kryesore që hasin ata përmendin buxhetin e ulët të bashkisë dhe mungesën e infrastrukturës përkatëse. Gjithsesi ata shprehen se përmes procesit të BP është rritur interesi i qytetarëve për të marrë pjesë dhe dhënë mendimin e tyre, por nuk vlerësojnë rëndësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve në të gjitha etapat e BP. Stafi i Bashkisë Kamëz rekomandon rritjen e numrit të takimeve me qytetarët dhe angazhim më të madh nga të gjitha institucionet.
- Të pyetur për nevojat e përmirësimit të këtij procesi, të gjithë të intervistuarit mendojnë që ka nevoja që lidhen me rritje e kapaciteteve, përmirësimin e burimeve financiare e njerëzore dhe sigurimin e infrastrukturës së duhur për realizimin e këtij procesi.

GJETJET KËSHILLI BASHKIAK

Këshilli i ri i bashkisë i dal nga zgjedhjet lokale 2019 ka 41 këshilltarë, 18 gra (44%) dhe 23 burra (56%). Në Bashkinë Kamëz ka Aleancë të Grave Këshilltare.

Për përgatitjen e këtij raporti u intervistuan 10 anëtarë të Këshillit Bashkiak.

- Nga intervistat e bëra rezultoi se të gjithë këshilltarët e shikonin shumë të rëndësishme dhe të rëndësishme pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimarrjen vendore.
- Një pjesë e tyre shprehen se e njihnin bazën ligjore dhe mendonin se ishte e qartë. Ata shprehen gjithashtu se ka shumë për të bërë në lidhje me mënyrën për sa i përket zbatimit të këtij procesi dhe hapave të realizimit të tij.
- Në bashki mungon një rregullore apo procedurë e brendshme e miratuar për realizimin e të gjitha hapave të buxhetimit me pjesëmarrje.
- Në lidhje me bashkëpunimin midis bashkisë dhe KB për zbatimin e procesit dhe për infrastrukturën e realizimit të saj, shumica shprehen se ka qenë i munguar. Vihet re paqartësi nga ana e të intervistuarve në lidhje me hapat, procedurat dhe mekanizmat e monitorimit. Ajo që nevojitet dhe që shfaqet gjatë intervistave është mungesa e një mekanizmi apo instrumenti për matjen e kënaqësisë qytetare.
- Në lidhje me ndikimin që ka pasur RAT në zbatimin e mekanizmave për angazhimin qytetar dhe konsultimin publik, të gjithë këshilltarët janë përgjigjur pozitivisht për sa i përket bazës ligjore dhe mundësisë që jep reforma për vetëadministrim, por nga ana tjetër kanë rezerva në lidhje me zbatimin e mekanizmave për angazhimin e qytetarëve.
- Disa prej nevojave kryesore, të sugjeruara nga këshilltarët për të përmirësuar më tej këto procese janë si mëposhtë:
 - Të rritet niveli ishpërndarjes së informacionit për qytetarët si për organizimin e dëgjësive ashtu edhe për vendimet e marra;
 - Të rritet transparenca e procesit;
 - Organizimi i dëgjësive me qytetarët të bëhet në ambiente të hapura, gjithëpërfshirëse dhe të mëdha për të përfshirë më shumë qytetarë e grupe interesi.
 - Të zhvillohen trajnime për këshilltarët dhe stafin e bashkisë në lidhje me procesin;
 - Takimet me qytetarët të jenë më të shpeshta.
 - Çdo komunitet të ketë një përfaqësi që të paraqesë kërkesat.
 - Të ketë komunikim të vazhdueshëm me qytetarët.
 - Të ngrihet një infrastrukturë e gatshme për operim.
 - Të ketë një buxhet të përcaktuar për këtë proces.
 - Të sigurohet asistencë teknike në lidhje me rritjen e kapaciteteve të këshilltarëve



**Përmirësimi i Procesit të
Buxhetimit të Konsultuar
dhe me Pjesëmarrje**

**Improvement of Consulted and
Participatory Budgeting Process**